

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



PUNIM I MASTERIT

**PËRFSHIRJA E NXËNËSVE NË AKTIVITETE REKREATIVO
SPORTIVE NË SHKOLLËN E MESME TË LARTË “SHABAN
SPAHIJA” NË KOMUNËN E PEJËS**

Mentori:
Prof. Dr. Bujar Turjaka

Kandidati:
Arben Jusenovic
Taulant Dupa

Prishtinë, prill 2018

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
1. HYRJE.....	5
1.1. HULUMTIMET E DERITANISHME.....	8
2. QËLLIMI I PUNIMIT	10
2.1. PROBLEM I HULUMTIMIT	11
3. HIPOTEZAT THEMELORE	12
4. METODAT E PUNËS.....	13
4.1. Mostra e entitetit.....	13
4.2. Mostra e variablave	13
4.2.1 Variablat e aplikuara.....	14
4.3. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE.....	18
5. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE.....	19
5.1. PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR - (Gjinia femrat)	19
5.2. PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR (GJINIA MESHKUJT)	37
5.3. NDRYSHIMET NË MES TË GJINIVE (T – testi)	55
6. ANALIZA DHE VERTETIMI I HIPOTEZAVE	58
7. PËRFUNDIMI.....	59
8. LITERATURA.....	61

ABSTRAKTI

Qëllimi i punimit: është paraqitja e nivelit të marrjes me aktivitete rekreativo-sportive tek nxënësit e shkollës së mesme të lartë në komunën e Pejës. Qëllim tjetër është që përmes pyetësorit të informohemi për të dhënat personale, për qëndrimin ndaj edukates fizike, për pjesëmarrjen aktive në aktivitete rekreativo-sportive e grupmohës së caktuar dhe për të dyja gjinitë. Qëllimi teorik i hulumtimit është të tregojë se nxënësit të cilët janë të angazhuar në rekreacionin sportiv kanë vetëdije më të lartë për shëndetin dhe mirqenien e tyre ndaj atyre të cilët nuk janë të përfshirë në sport dhe rekreacionin sportiv si dhe fitojnë shprehi të re të jetesës në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Qëllimi praktik i hulumtimit është që në bazë të rezultateve të hulumtimit të fitohen të dhëna të vlefshme dhe interesante rreth vetëdijes së nxënësve mbi edukimin fizik si dhe pengesat që paraqiten për pjesëmarrje aktive të tyre me sport. Popullata e trajtuar në këtë punim përbëhet nga nxënësit e klasave të dhjeta të shkollës së mesme të lartë “Shaban Spahija” në komunën e Pejës. Mostra e të anketuarve do të përfshij 200 nxënës të moshës pesëmbëdhjet vjeçare, të të dyja gjinive, domethënë nga 100 të anketuar për të dy gjinitë.

Metodat: Si instrument i hulumtimit është përdor pyetësori, i modifikuar dhe formuluar enkas për qëllime të hulumtimit. Një grup i pyetjeve na ka siguruar të dhëna rreth pjesëmarrjes në aktivitete fizike dhe llojin e tyre, ndërsa grupi tjetër i pyetjeve ka të bëjë me pyetjet rreth shprehive të jetës së nxënësve të anketuar.

Rezultatet: Në përgjithsi rinia e moshës 15 vjeçare e qytetit të Pejës nuk janë të painformuar sa i përket rëndësisë së marrjes me aktivitete fizike si dhe për rrezikun nga shprehitë e mosaktivitetit fizik. Dallimet të cilat egzistojnë në nivel të përfshirëjes në aktivitete rekreative-sportive janë të theksuara në mes të femrave dhe meshkujve të kësaj moshe. Meshkujt janë dukshëm më shumë të përfshirë në aktivitetet rekreative dhe në klube sportive.

Fjalët kyçe: Nxënësit, aktivitetet sportive, shprehitë e jetesës, pyetësori, dallimet.

ABSTRACT

Purpose: To present the level of participation in sports - recreational activities amongst high school students, in Peja. Another purpose is to collect personal data, attitude towards physical education, active participation in sports – recreational activities amongst different age groups and genders, through questionnaire. The theoretical purpose of the study is to show that students engaging in recreational sports activities have a higher awareness of the importance of their health, their wellbeing and the impact on the acquisition of good habits of life, in contrary to those who don't engage in sports – recreational activities. The practical purpose is to acquire significant and interesting data from the study results, concerning the awareness of students of physical education and the barriers due to non-participating in sports. The population involved in this study, consists of 10th grade high school students from “Shaban Spahija” high school in Peja. The total sample consists of 100 male and 100 female students, age group 15 years old, resulting in 200 students in total.

Methods: The questionnaire is used as a reserach tool, modified and reworded especially for reserach purposes. A set of questions has provided us with information about the participation in physical activities and their type, while the other set of questions relates to questions about the life habits of the students.

Results: In general, 15 year olds in Peja are well informed about the importance of engaging in physical activity, as well as about the risks of non-participating in physical activities. The differences amongst female and male respondents of this age, are emphasized in their engagement in physical activities. Men are significantly more involved in recreational activities and in sports clubs.

Key words: Students, physical activities, life habits, questionnaire, differences.

1. HYRJE

Dikur nuk ka pasur nevojë për të formuar shprehjet për ushtrime fizike, sepse aftësitë fizike të njeriut janë formuar me anë të punës së përditshme dhe aktivitete të tjera. Megjithatë, automatizimi i përgjithshëm dhe mekanizimi çoi në faktin se njeriu e ka reduktuar aktivitetin e tij fizik në minimum dhe jo vetëm në punë, por në kohën e tij të lirë. Sot shoqëria moderne është në rrugë për të shkatërruar kushtet e jetës. Çdo gjë është e ndotur: uji, ajri, toka. Por ky nuk është fundi, këtyre fakteve duhet të shtohet edhe mungesa e lëvizjes së njeriut, si dhe mungesa e qëndrimit në ambiente të hapura, në natyrë, dhe e gjithë kjo është për shkak të zhvillimit teknologjik. Pra, sëmundja më e madhe sot është "mungesa e lëvizjes dhe qëndrimit në ambiente të hapur dhe në kushte natyrore".

Rekreacioni fizik është aktivitet vullnetar i njeriut në kohën e lirë, e motivuar kryesisht duke plotësuar nevojat për lëvizje. Rekreacioni paraqet shprehje spontane të dëshirës së njeriut për plotësimin e nevojave dhe interesave përmes aktiviteteve sipas zgjedhjes personale, me qëllim të freskimit, pushimit, argëtimit dhe shfrytëzimit sa më racional të kohës.

Rekreacioni sportiv është sistem specifik i metodave të ndryshme, përmbajtjeve dhe formave të ushtrimeve trupore, komform aftësive, mundësive, nevojave dhe interesave të njerëzve, qëllimi i të cilve është zhvillimi i aftësive funksionale dhe punuese, përparimi i shëndetit, rritja e produktivitetit dhe humanizimit të punës si dhe përmirësimi i kualitetit të jetës.

Organizata botërore e shëndetësisë **WHO (World Health Organization)** që nga themelimi i saj përpaket nëpërmjet një "letëre të hapur" drejtuar të gjitha qeveritë të botës, të tregoj për efektet pozitive të një aktiviteti të rregullt fizik në të gjitha strukturat e qytetarëve. WHO thekson se aktiviteti i pamjaftueshëm fizik, është i dukshëm në jetën e përditshme dhe në punë, sidomos kërcënon: fëmijët e moshës parashkollore, adoleshentët, personat e ekspozuar ndaj situatave stresuese, gratë, njerëzit në moshën e tretë dhe ata që vuajnë nga sëmundje kronike (obeziteti, hipertensioni, diabeti, osteoporozë...). Aktiviteti i pamjaftueshëm fizik është caktuar në këtë mënyrë si një faktor rreziku për jetë për kategoritë e përmendura të qytetarëve.

Periudha e moshës shkollore është konsideruar shumë e rëndësishme për zhvillimin e duhur kur është fjala për aktivitet fizike, në gjendjen shëndetsore, ngritjen e gjendjes së përgjithshme fizike dhe punuese, ngritjen dhe përmirësimin e efikasitetit, ndikon në masë të madhe rekreacioni. Për shkak të obligimeve të mëdha në shkollë nxënësve iu mbetet pak kohë për t'u angazhuar në aktivitete fizike. Prandaj është shumë e rëndësishme se si dhe në çfarë mënyrë të përmbushin kohën e lirë, që ajo të jetë në funksion me shëndetin, parandalimin dhe përmirësimin e të gjitha aftësive të nxënësve. Nxënësit kanë nevojë biologjike për të lëvizur, loja dhe argëtimi janë arsyt kryesore për zbatimin dhe futjen e aktiviteteve jashtëshkollore të sportit dhe rekreacionit në shkollë.

Si një fushë e veçantë e edukimit fizik, rekreacioni sportiv është i përqendruar në përputhje me nevojat përkatëse të njeriut dhe interesave që ndodhin në ditët e sotme. Për të arritur këtë duhet të ofrojë aktivitete rekreative sportive, të cilat janë gjerësisht në dispozicion dhe në përputhje me nivelin e aftësive, gjendjes shëndetësore, gjinisë dhe karakteristikës së moshës tek çdo individ. Nga e gjithë kjo, pa dyshim mund të kuptojmë se sa është e nevojshme qysh nga mosha e re, dmth. periudha e fëmijërisë së hershme, të punojmë për të krijuar një shprehje për ushtrime fizike të përditshme, realizimi i nevojës për të lëvizur, si dhe për të zhvilluar vetëdijen për rëndësinë e lartpërmendur.

Aktiviteti fizik dhe rekreativ është gjithashtu një mënyrë shumë e mirë për të nxjerrë fëmijët në ajër të pastër, duke ushtruar dhe duke u argëtuar. Në sportet rekreative përfitojnë të gjithë fëmijët jo vetëm proatletët e ardhshëm. Edhe nëse një fëmij ka vetëm aftësi atletike të moderuar ose duket "jo-atlet", një program i mirë sportiv rekreativ mund të jetë një mënyrë e shkëlqyeshme për të zhvilluar aftësitë e tyre njohëse dhe fizike. Ky zhvillim do t'i ndihmojë ata në të gjitha fushat e jetës së tyre dhe do të ndërtojë vetëbesimin e tyre.

Zhvillimi kognitiv i një fëmije i referohet aftësisë së tyre për të menduar dhe për të arsyetuar. Ky zhvillim fillon në foshnjëri dhe vazhdon edhe në moshë madhore. Ai përfshin aftësinë për të zgjidhur, komunikuar, marrë vendime dhe arsye logjike.

Këto lloje të momenteve janë mundësi të shkëlqyera për fëmijët që të praktikojnë shpejt vlerësimin e një situatë dhe marrjen e një vendimi. Kjo u mëson fëmijëve se si të komunikojnë me fëmijët dhe të rriturit dhe si të punojnë mirë me të tjerët për të arritur një qëllim të përbashkët.

Aftësitë motorike i referohen aftësisë së një personi për të kontrolluar lëvizjet e muskujve pa probleme dhe me saktësi. Pjesëmarrja në sportet rekreative do t'ju mundësoj fëmijëve të zhvillojnë ekuilibrin, gatishmërinë, shpejtësinë dhe fleksibilitetin. Sportet mësojnë fëmijët të gjuajnë, hedhin, drejtojnë, kapin dhe kërcejnë.

Gjithashtu aktivitete fizike rekreative kontrollojnë peshen trupore, sigurojnë lëvizshmëri më të mirë të nyjeve, rrisin forcën e eshtrave, zvoglojnë rrezikun nga paraqitja e osteoporozës, përmirësojnë ekuilibrin dhe koordinimin, përmirësojnë frymëmarrjen, përmirësim të gjumit dhe vlerave energjetike etj.¹

Rekreacioni ndikon edhe në ekonomi, hulumtimet e bëra nga Econtech(2008) thanë: "Nëse më shumë australianë do të ishin fizikisht aktivë për vetëm 30 minuta në ditë në sistemin shëndetësor Australian mund të shpëtojnë 1.5 miliard dollarë në vit"²

¹ Prof.dr. Bujar Turjaka- "Rekreacioni dhe mireqenia"

² Medibank (2008), The cost of physical inactivity, Medibank Private, Sydney.

1.1. HULUMTIMET E DERITANISHME

Disa prej materialeve dhe literaturës që kemi pasur në dispozicion, në mes tjerash duhet të përmendim këto hulumtime:

Datalys center for sport Injury research and prevention- Një studim i shkollave të mesme publike zbuloi se 29% e djemve dhe 34% e vajzave janë mbipeshë dhe 16% e djemve dhe vajzave janë të plotë. Në këto shkolla, studentët që morën pjesë në një ose më shumë sporte kishin shumë më pak gjasa të ishin mbipeshë ose të plotë. Një studim i vitit 2012 zbuloi se rreth 29% e studentëve në Hampshire dhe Vermont ishin ose mbipeshë ose të plotë, por nxënësit që merrnin pjesë në një ose më shumë ekipe sportive kishin më pak gjasa të jenë mbipeshë ose të plotë në krahasim me jo pjesëmarrësit. Studiuesit vlerësuan se nëse të gjithë adoleshentët do të luanin në një ose më shumë skuadra sportive në vit, obezitetit do ulje me 26%.

Nihiser AJ, Lee SM, Wechsler H, McKenna M, Odom E, Reinold C, Thompson D, Grummer-Straën L-Një panel ekspertësh, i thirrur nga Qendrapër Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) në vitin 2005 që përbëhej nga ekspertë të shëndetësisë publike, arsimit, këshillimit shkollor, kujdesit shëndetësor dhe një organizatë e prindërve. Kanë bërë një artikull ku përshkruan qëllimet e programeve të matjes së BMI-së, shqyrton praktikën e tanishme, shqyrton kërkimet ekzistuese, përmbledh rekomandimet e ekspertëve, identifikon shqetësimet dhe siguron udhëzime duke përfshirë një listë të masave mbrojtëse dhe ide për hulumtime të ardhshme. Rezultatet e dala nga ky artikull ishte që zbatimi i matjes së BMI-së me bazë në shkollë për qëllime vëzhgimi, domethënë për të identifikuar përqindjen e nxënësve në një popullatë që është në rrezik për probleme të peshës pranohet gjerësisht mbi matjen e BMI-së për qëllime të shqyrtimit, domethënë, për të vlerësuar gjendjen e peshës së nxënësve dhe për t'i dhënë informacione dhe udhëzime prindërve për veprim.

Ruggieri DG, Bass SB - Ndërsa legjislacioni për programet e mbikëqyrjes dhe programeve të shqyrtimit të indeksit të masës trupore (BMI) ka kaluar në 25 shtete, programet shpesh janë subjekt i debateve etike rreth konfidencialitetit dhe privatësisë, komunikimit nga shkolla në prind, si dhe sigurisë dhe vetëvlerësimit për studentët. Përkundër këtij debati, nuk është përfunduar asnjë analizë gjithëpërfshirëse që krahason dhe kontraston se si këto çështje ndikojnë në mënyrë të ndryshme në shkolla, prindër dhe

studentë. Ky artikull trajton hendekun e literaturës së mëparshme duke përvijuar konsideratat etike dhe implikimet që kanë programet e skanimit të BMI-së dhe kartat e raportimit për shkollat, prindërit dhe studentët dhe i lidh këto me studimet e rezultateve për të adresuar nëse këto polemika mbështeten nga hulumtimi. Pavarësisht polemikave që rrethojnë këto programe, ky rishikim tregon se ato mund të jenë të vlefshme për të gjitha palët dhe demonstroi që programet e kontrollit të BMI-së janë jetike për zhvillimin e programeve të fuqishme të parandalimit të trashjes në shkollë dhe promovimin e mënyrave të jetesës së shëndetshme në shkollë.

Burns RD, Fu Y, Hannon JC, Brusseau TA në një hulumtim të publikuar në **PUBMED** Në shqyrtimin e efektit të një programi gjithëpërfshirës të aktivitetit fizik në shkollë (CSPAP) mbi aftësitë motorike të fëmijët ku u përfshinë 959 fëmijë nga 5 shkollë. Të dhënat u grumbulluan në fillim të vitit shkollor dhe në fund të 36 javorit të hulumtimit. Aftësitë motorike u vlerësuan duke përdorur testin për zhvillimin e brendshëm të aftësive motorike duke u bazuar në moshën dhe gjininë si modifikues të efektit dhe duke përshtatur për grumbullimin e vëzhgimeve brenda strukturës së të dhënave. Fëmijët treguan rezultate të përmirësuara të aftësisë motorike bruto në fund të 36 javorit hulumtues.

Chace M, Vilvens H. -Marrëveshjet e përdorimit të përbashkët (SUA) që lejojnë përdorimin e objekteve shkollore publike nga komuniteti janë rekomanduar si një nga strategjit kryesore për shëndetin publik dhe për rritjen e aktivitetit fizik. Qëllimi i këtij studimi ishte të shqyrtojë natyrën dhe shtrirjen aktuale të SUA në Ohajo, si dhe përfitimet, pengesat dhe nevojat e perceptuara të administratorëve shkollorë. Përfitimet e perceptuara më së shpeshti përfshijnë përmirësimin e marrëdhënieve me tatimpaguesit. Sipas administratorëve të shkollave, dyert e tyre janë të hapura deri në një farë mase, por shumica e SUA-s ishin marrëveshje joformale. Përpjekjet e avokimit për SUA duhet të përfshijnë kalimin e një ligji të nivelit shtetëror që siguron imunitet të arsyeshëm ndaj përgjegjësisë. Përhapja në komunitetin e shkollës duhet të përfshijë shembuj të marrëveshjeve zyrtare me shkrim, shembuj të menaxhimit të kostos novatore dhe hulumtime të përditësuara mbi lidhjen e aktivitetit fizik me mësimnxënien dhe performancën akademike.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllim i këtij punimi është paraqitja e nivelit të marrjes me aktivitete rekreativo-sportive tek nxënësit e shkollës së mesme të lartë në komunën e Pejës.

Qëllim tjetër është që përmes pyetsorit të informohemi për të dhënat personale, për qëndrimin ndaj edukates fizike, për pjesëmarrjen aktive në aktivitete rekreativo-sportive e grupmohës së caktuar dhe për të dyja gjinitë.

Qëllimi teorik i hulumtimit është të tregojë se nxënësit të cilët janë të angazhuar në rekreacionin sportiv kanë vetëdije më të lartë për shëndetin dhe mirqenien e tyre ndaj atyre të cilët nuk janë të përfshirë në sport dhe rekreacionin sportiv si dhe fitojnë shprehi të re të jetesës në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Qëllimi praktik i hulumtimit është që në bazë të rezultateve të hulumtimit të fitohen të dhëna të vlefshme dhe interesante rreth vetëdijes së nxënësve mbi edukimin fizik si dhe pengesat që paraqiten për pjesëmarrje aktive të tyre me sport.

Punimi do përpiket që të japë një psqyrë të qartë të ndikimit në aktivitetet rekreativo sportive, në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies si dhe nivelit të informimit mbi rëndësinë e ushtrimeve për grupmoshat e trajtuara në punim.

2.1. PROBLEM I HULUMTIMIT

Pasiviteti fizik i fëmijëve, veçanërisht adoleshentëve, ka një ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik dhe shpirtëror. Kjo veçanërisht rrezikon shëndetin e individëve. Kur ka pak kushte për sporte rekreative atherë një numër i madh hjek dorë nga ushtrimet dhe sporti në kohën e lirë. Shumë prej tyre kanë kushtuar rëndësi aktiviteteve të cilat janë më pak të shëndetshme, dhe kjo ka rezultuar në një rritje të numrit të pacientëve që vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore, dhe kanë ndikuar në rritjen e numrit të varur nga alkooli dhe droga.

Kohëve të fundit përkundër promovimit të madh sporti prap se prap po neglizhohet dhe si rrjedhojë e kësaj situatë janë paraqitur shumë probleme shëndetsorre të kushtëzuara nga jeta bashkohore. Para së gjithash, është reduktuar numri i orëve javore të edukates fizike. Problemi është numri i pamjaftushëm i palestrave si dhe mungesa e paisjeve. Kjo kryesisht ndikon në cilësinë e mësimdhënies, sigurinë e nxënësve si dhe angazhimin e mësuesve. Që fëmijët të kenë arsim cilësor, duhet të kenë një arsimim cilësor fizik. Ajo mundëson zhvillimin individual, ndërton vlerat etike, komunikimin, ndikojnë në bashkëpunimin, punën në grup, duke pranuar fitoren dhe humbjen, lojë të ndershme dhe kështu me radhë.

Qëllimi i edukimit fizik është ndërtuar në sistemin e vlerave arsimore. Edukimi fizik kontribon në formimin e personalitetit në përgjithësi andaj ky ka qenë edhe motivi jonë për shtjellimin e kesaj problematike dhe sado pak të janpim një kontribut në këtë drejtim.

Edukata fizike është e vetmja lëndë shkollore që është e fokusuar në aktivitet fizik, zhvillim fizik dhe shëndetin e nxënësve. Plani duhet të specifikojë një numër të mjaftueshëm të orëve në të cilat do të jetë e mundur të përmbushet misioni i arsimit cilësor fizik dhe sportit shkollor. Më e rëndësishme është që ushtrimet fizike të përfshihen në jetën e përditshme të nxënësve.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë së hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat e aplikuara për përpunimin e rezultateve parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Presim se ndryshimet në vlerat e fituara te variablat e aplikuara në këtë punim do të jenë statistikisht të rëndësishme.

H₀₂– Presim se do të ketë ndryshime të rëndësishme në mes gjinive të trajtuara në punim në kuptimin e qëndrimit ndaj edukatës fizike (ku vlerat statistikore do të jenë në favor të gjinisë mashkullore).

H₀₃– Presim se do të ketë ndryshime të rëndësishme në mes gjinive të trajtuara në punim në kuptimin e pjesmarrjes në aktivitete rekreativo-sportive.

4. METODAT E PUNËS

Ky studim i përket kategorisë së kërkimeve empirike, ndërsa sipas qëllimit të ndërrmarr paraqet hulumtim aplikativ i cila ka për qëllim të fitoj njohuri dhe informacioneve të reja të nevojshme për nivelin e pjesmarrjes me aktivitete rekreative si dhe shprehitë individuale tek rinia e komunës së Pejës.

Sipas qëllimit të hulumtimit, ky kërkim paraqet njohurit dhe informatat e reja në pjesmarrjen e nxënësve në aktivitete fizike dhe ndikimi tyre tek shprehit personale.

Çdo kërkim hulumtues mund të ketë mënyra të ndryshme deri tek arritja e rezultateve duke vërtetuar hipotezat e parashtruara me metodat e përshtatshme kërkimore.

Ky hulumtim është i karakterit transfersal i cili na jep informata të reja për nxënësit e trajtuar në këtë hulumtim.

4.1. Mostra e entitetit

Popullata e trajtuar në këtë punim përbëhet nga nxënësit e klasave të dhjeta të shkollës së mesme të lartë “Shaban Spahija” në komunën e Pejës.

Mostra e të anketuarve do të përfshij 200 nxënës të moshës pesëmbëdhjet vjeçare, të të dyja gjinive, domethënë nga 100 të anketuar për të dy gjinitë.

4.2. Mostra e variablave

Instrument i hulumtimit do të jetë pyetësori, i cili është posaçërisht i konstruktuar për këtë hulumtim. Vlerësimi i shprehive të jetesës ku treguesit kryesor janë të dhënat, në lidhje me: pyetjet personale, konsumimi i cigareve dhe alkoolit, ushqimi dhe gjumi i rregullt, me njohurit e mësimi të edukatës fizike, kohën e lirë dhe marrja me aktivitete rekreative - sportive.

4.2.1 Variablat e aplikuara

Do të aplikohen këto variabla ose pyetësor:

1. Gjinia:

- a. Femër,
- b. Mashkull.

2.Sa vjeç je:

- a. 14,
- b. 15,
- c. 16.

3. Ku jeton:

- a. Qytet,
- b. Fshatë,

4.Sa orë gjumë bën:

- a. 6 - 8 orë,
- b. 8 - 9 orë,
- c. 9 - 10 orë.

5. Sa herë ushqehesh në ditë (shutja ditore):

- a. 2 herë,
- b. 3 herë,
- c. 4 herë.

6. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditorë:

- a. 10 - 20 cigare,
- b. Më tepër se 20 cigare,
- c. Nuk e konsumoj.

7. Konsumimi i alkoolit:

- a. Rregullisht (çdo ditë),
- b. Kohë pas kohe (nga njëherë në javë),
- c. Nuk e konsumoj.

8.A është e rëndësishme ora e edukatës fizike:

- a. Është shumë e rëndësishme,
- b. Po, është e rëndësishme,
- c. Nuk është e rëndësishme.

9. Kur kishe pasur mundësi të lirohesh nga orët e edukatës fizike, a e kishe shfytëzu:

- a. E kisha shfrytëzu pa u mendu,
- b. Së pari kisha menduar mirë,
- c. Nuk e kisha shfrytëzu.

10. A ke fituar njohuri përmes orës së edukatës fizike, me të cilën mund të merresh me ushtrime në kohën e lirë:

- a. Jo,
- b. Pjesërisht,
- c. Po.

11. A ndihesh i aftë për të krijuar një program të ushtrimeve për veten:

- a. Jo,
- b. Pjesërisht,
- c. Po.

12. Sa të intereson sporti, rekreacioni dhe aktiviteti fizik:

- a. Nuk më intereson fare,
- b. Kryesisht më intereson,
- c. Jam shumë i interesuar.

13. Sa merresh me ndonjë aktivitet fizik apo rekreacion në kohën e lirë:

- a. Rregullisht (të paktën tre herë në javë),
- b. Së paku një herë në javë,
- c. Nuk merrem.

14. A je antar e ndonjë organizate sportive:

- a. Klub sportiv,
- b. Organizat sportive shkollore,
- c. Jo.

15. Nëse je i angazhuar në ndonjë sport të caktuar (klub), sa herë në javë jë aktiv:

- a. Rregullisht (katër herë në javë),
- b. Rregullisht (tri herë në javë),
- c. Nuk jam i angazhuar.

16. A bën gjimnastikë të mëngjesit:

- a. Shpesh,
- b. Nganjëherë,
- c. Kurrë.

17. Sa shpesh shkon në pishinë:

- a. Shkoj shpesh,
- b. Shkoj vetëm veres,
- c. Nuk shkoj.

18.A ke qenë deri tani në skijim:

- a. Kurrë,
- b. Një herë,
- c. Dy ose më shumë herë.

19. Si ke dëshir të shkosh në pushime verore - dimërore:

- a. Me shkollë,
- b. Me prindërit,
- c. Me miqtë, shokët.

20.Sa herë brenda viti ke qenë në ndonjë sheti, udhëtim turistik jashtë vendbanimit:

- a. Një herë,
- b. Dy deri katër herë,
- c. Më shumë se pesë herë.

4.3. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Duke marrë parasysh qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që do të hulumtohen.

Për çdo variabël brenda pyetsorit, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma),
- Devijimi standard (Ds),
- Vlera minimale (Min),
- Vlera maksimale (Max).

2. Nga hapësirat e statistikës komparative (krahasuese) për dy grupe të mostrave të pavarura është përdor procedura diskriminative, para se gjithash, analiza parashikuese (**t -testi**) e cila aplikohet për të shqyrtuar dallimin mes grupmoshës tek dy gjinitë.

5. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

5.1. PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR - (Gjinia femrat)

Tabela 1. Ku jeton?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	fshat	55	55,0	55,0	55,0
	qytet	45	45,0	45,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “Ku jeton”, nga 100 të anketuar, 55 janë deklaruar se jetojnë në fshat apo shprehur në përqindje 55%, ndërsa 45 të tjerë jetojnë në qytet apo 45%.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 2. Sa orë gjumë bën?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	6-8 orë	51	51,0	51,0	51,0
	8-9 orë	34	34,0	34,0	85,0
	9-10 orë	15	15,0	15,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “Sa orë gjumë bën”, nga 100 të anketuar, 51 bëjnë gjumë 6-8 orë apo shprehur në përqindje 51 %, 34 bëjnë gjumë 8-9 orë apo 34 %, si dhe 15 bëjnë gjumë 9-10 orë apo 15 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 3. Sa herë ushqehesh në ditë (shutja ditore)?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2 herë	55	55,0	55,0	55,0
	3 herë	36	36,0	36,0	91,0
	4 herë	9	9,0	9,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “Sa herë ushqehesh në ditë (shutja ditore)”, nga 100 të anketuar, 55 ushqehen 2 herë në ditë apo shprehur në përqindje 55 %, 36 ushqehen 3 herë në ditë apo 36 %, si dhe 9 ushqehen 4 herë në ditë apo 9 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 4. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditorë?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	10-20 cigare	2	2,0	2,0	2,0
	mbi 20	2	2,0	2,0	4,0
	nuk pi duhan	96	96,0	96,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditorë”, nga 100 të anketuar, 2 e konsumojnë 10-20 cigare në ditë apo shprehur në përqindje 2 %, 2 e konsumojnë mbi 20 cigare në ditë apo 2 %, si dhe 96 nuk konsumojnë cigare apo 96 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 5. Konsumimi i alkoolit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	kohëpaskohe	5	5,0	5,0	5,0
	nuk e konsumoj	95	95,0	95,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “Konsumimi i alkoolit”, nga 100 të anketuar, 5 e konsumojnë alkoolin kohë pas kohe apo shprehur në përqindje 5 %, si dhe 95 nuk e konsumojnë alkoolin apo 95 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 6. A është e rëndësishme ora e edukatës fizike?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shumë me rëndësi	41	41,0	41,0	41,0
	po, është me rëndësi	57	57,0	57,0	98,0
	nuk është me rëndësi	2	2,0	2,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “A është e rëndësishme ora e edukatës fizike”, nga 100 të anketuar, 41 janë përgjigjur që është shumë e rëndësishme ora e edukatës fizike apo shprehur në përqindje 41 %, 57 janë përgjigjur po, është e rëndësishme apo 57 %, si dhe 2 që nuk është e rëndësishme apo 2 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 7. Kur kishe pasur mundësi të lrohesh nga orët e edukatës fizike, a e kishe shfytëzu?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	po, pa u mendu	8	8,0	8,0	8,0
	së pari do mendoja	43	43,0	43,0	51,0
	nuk do e shfrytëzoja	49	49,0	49,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetjen “Kur kishe pasur mundësi të lrohesh nga orët e edukatës fizike, a e kishe shfytëzu”, nga 100 të anketuar, 8 janë përgjigjur po, pa u mendu apo shprehur në përqindje 8 %, 43 janë përgjigjur së pari kisha menduar mirë apo 43 %, si dhe 49 nuk do e shfrytëzoja apo 49 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 8. A ke fituar njohuri përmes orës së edukatës fizike, me të cilën mund të merresh me ushtrime në kohën e lirë?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	4,0	4,0	4,0
	pjesërisht	25	25,0	25,0	29,0
	Po	71	71,0	71,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “A ke fituar njohuri përmes orës së edukatës fizike, me të cilën mund të merresh me ushtrime në kohën e lirë”, nga 100 të anketuar, 4 janë përgjigjur jo apo shprehur në përqindje 4 %, 25 janë përgjigjur pjesërisht apo 25 %, si dhe 71 po apo 71 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtuar




Tabela 9. A ndihesh i aftë për të krijuar një program të ushtrimeve për veten?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	18	18,0	18,0	18,0
	pjesërisht	30	30,0	30,0	48,0
	Po	52	52,0	52,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “A ndihesh i aftë për të krijuar një program të ushtrimeve për veten”, nga 100 të anketuar, 18 janë përgjigjur jo apo shprehur në përqindje 18 %, 30 janë përgjigjur pjesërisht apo 30 %, si dhe 52 po apo 52 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 10. Sa të intereson sporti, rekreacioni dhe aktiviteti fizik?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	nuk më intereson fare	3	3,0	3,0	3,0
	kryesisht më intereson	65	65,0	65,0	68,0
	shumë i interesuar	32	32,0	32,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “Sa të intereson sporti, rekreacioni dhe aktiviteti fizik”, nga 100 të anketuar, 3 janë përgjigjur nuk më intereson fare apo shprehur në përqindje 3 %, 65 janë përgjigjur kryesisht më intereson apo 65 %, si dhe 32 shumë i intereson apo 32 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 11. Sa merresh me ndonjë aktivitet fizik apo rekreacion në kohën e lirë?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulativ e Percent
Valid	rregullisht	22	22,0	22,0	22,0
	së paku 1 herë në javë	60	60,0	60,0	82,0
	nuk merrem	18	18,0	18,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “Sa merresh me ndonjë aktivitet fizik apo rekreacion në kohën e lirë”, nga 100 të anketuar , 22 janë përgjigjur rregullisht apo shprehur në përqindje 22 %, 60 janë përgjigjur së paku 1 herë në javë apo 60 %, si dhe 18 që nuk merren apo 18 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 12. A je antar e ndonjë organizate sportive?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulati ve Percent
Valid	klub sporti	7	7,0	7,0	7,0
	OS shkollore	2	2,0	2,0	9,0
	Jo	91	91,0	91,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “A je antar e ndonjë organizate sportive”, nga 100 të anketuar, 7 janë përgjigjur në klub sportiv apo shprehur në përqindje 7 %, 2 janë përgjigjur në organizat sportive shkollore apo 2 %, si dhe 91 jo apo 91 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 13. Nëse je i angazhuar në ndonjë sport të caktuar (klub), sa herë në javë jë aktiv?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	rregullisht	4	4,0	4,0	4,0
	3 herë në javë	5	5,0	5,0	9,0
	nuk jam i angazhuar	91	91,0	91,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “Nëse je i angazhuar në ndonjë sport të caktuar (klub), sa herë në javë jë aktiv”, nga 100 të anketuar, 4 janë përgjigjur rregullisht apo shprehur në përqindje 4 %, 5 janë përgjigjur 3 herë në javë apo 5 %, si dhe 91 që nuk janë të angazhuar apo 91 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtuar




Tabela 14. A bën gjimnastikë të mëngjesit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shpesh	11	11,0	11,0	11,0
	nganjëherë	71	71,0	71,0	82,0
	kurrë	18	18,0	18,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “A bën gjimnastikë të mëngjesit”, nga 100 të anketuar, 11 janë përgjigjur shpesh apo shprehur në përqindje 11 %, 71 janë përgjigjur nganjëherë apo 71 %, si dhe 18 që nuk bëjnë kurrë apo 18 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 15.Sa shpesh shkon në pishinë?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shpesh	12	12,0	12,0	12,0
	vetëm verës	80	80,0	80,0	92,0
	nuk shkoj	8	8,0	8,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “Sa shpesh shkon në pishinë” , nga 100 të anketuar, 12 janë pergjigjur shpesh apo shprehur në përqindje 12 %, 80 janë pergjigjur vetëm verës apo 80 %, si dhe 8 që nuk shkojnë apo 8 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 16. A ke qenë deri tani në skijim?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	kurrë	57	57,0	57,0	57,0
	një herë	24	24,0	24,0	81,0
	2 ose më shumë	19	19,0	19,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

Në pyetje “A ke qenë deri tani në skijim”, nga 100 të anketuar, 57 janë përgjigjur kurrë apo shprehur në përqindje 57 %, 24 janë përgjigjur një herë apo 24 %, si dhe 19 ose më shumë herë apo 19 %.

Paraqitja grafike e përqindjes (%) në pyetjen e parashtruar




Tabela 17. Si ke dëshir të shkosh në pushime verore - dimërore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	me shkollë	10	10,0	10,0	10,0
	me prindër	52	52,0	52,0	62,0
	me miq, shok	38	38,0	38,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

a. GJINIA = femër

